REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.10.2022)

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

1.1 "Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat".

1.2 "Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë".

1.3 "Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës".

1.4 "Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrativë të Shkallës së Parë Vlorë".

1.5 "Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrativë të Shkallës së Parë Gjirokastër".

1.6 "Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Apelit Durrës".

1.7 "Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Apelit".

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në

orën 12:15 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e pesë pikave të para të rendit të ditës Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Naureda Llagami.***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Paola Ndroqi, Përfaqësuese e Universitetit "Epoka".

4. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

5. Edmond Hoxhaj

6. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

1.1 "Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave

të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat".

1.2 "Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë".

1.3 "Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës".

1.4 "Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrativë të Shkallës së Parë Vlorë".

1.5 "Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrativë të Shkallës së Parë Gjirokastër".

1.6 "Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Apelit Durrës".

1.7 "Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Apelit".

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë, vazhdojmë mbledhjen e ditës së sotme, datë 4 tetor 2022.

Pika e parë e saj (sipas rendit) është shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën ia jap zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Përshëndetje kolegë!

Për ditën e sotme është caktuar në rendin e ditës, në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, edhe relacionet që kemi dërguar ne si Komision i Zhvillimit të Karrierës, relacione që kanë një objekt të përbashkët për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave që kanë bërë disa gjykata në Republikën e Shqipërisë, për caktim gjyqtari në gjykimin e çështjeve gjyqësore konkrete.

Të gjitha projektvendimet që ne kemi dërguar, siç thashë, kanë një objekt të përbashkët pasi në kohën kur janë paraqitur kërkesat, gjykatat në nevojë nuk kanë pasur numrin e nevojshëm të gjyqtarëve për të shqyrtuar çështje të veçanta për shkak të papajtueshmërive që kanë pasur gjyqtarët dhe për shkak të numrit të kufizuar të

gjyqtarëve, por më pas me caktimin në detyrë të kandidatëve për magjistratë, viti i tretë, si gjyqtarë në gjykatat respektive, ka rënë edhe objekti i kërkesave të paraqitura nga disa gjykata të cilat unë po i përmend: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata Administrative e Apelit me qendër në Tiranë.

Meqenëse, siç thashë, ka rënë shkaku ligjor që ka mbajtur në shqyrtim/zhvillim kërkesat e paraqitura nga këto gjykata, ne kemi propozuar për secilin rast (për secilën kërkesë paraqitur nga këto gjykata) që, të deklarojmë të përfunduar pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave, respektivisht të kërkesave të paraqitura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata Administrative e Apelit me qendër në Tiranë.

Pra bëra një relacion përmbledhës për të gjitha rastet, meqenëse të gjitha rastet kanë një objekt të përbashkët. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit, zoti Kurushi!

Ka ndonjë diskutim nga anëtarët e Këshillit mbi çka u parashtrua nga zoti Kurushi?

Atëherë, kalojmë në miratimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim "Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të gjykatave për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar bazës ligjore përkatëse, vendosi:

I. Të deklarojë të përfunduar, pa një vendim përfundimtar, shqyrtimin e kërkesave të gjykatave për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, si më poshtë:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat

- Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së rrethit gjyqësor Berat si vijon:

1. Kërkesës nr. {...} prot., datë 12.07.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me objekt: Trafikim i personave të rritur.

2. Kërkesës nr. {...} prot., datë 12.07.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me objekt: Mbajtje dhe prodhim pa leje i armëve shpërthyese dhe municionit. Prodhim e shitje narkotikësh.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë

- Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së rrethit gjyqësor Lezhë si vijon:

1. Kërkesës nr. {...} prot., datë 15.07.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore civile me paditës shoqëria "{...}" shpk, me të paditur {...}me objekt "Detyrim njohje pronar".

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës

- Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së rrethit gjyqësor Kukës si vijon:

1. Kërkesës nr. {...} prot., datë 07.07.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me objekt "Dërgimin e çështjes në gjyq" në ngarkim të të pandehurit: {...}; akuzuar për veprën penale "Fshehje e të ardhurave" parashikuar nga Neni 180/1 i Kodit

Penal.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë

- Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë si vijon:

1. Kërkesës nr. {...} prot., datë 05.07.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me objekt "Shpërblim dëmi" me palë paditëse {...} dhe palë të paditur Shoqëria {...} "{...}" shpk.

2. Kërkesave nr. {...} dhe {...} prot., datë 30.06.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me objekt "Detyrim pagim shume" me palë paditëse {...} dhe palë të paditur Shoqëria "{...}" sh.a.

3. Kërkesave nr. {...} dhe nr. {...} prot., datë 30.06.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me objekt "Detyrim kthim shume" me palë paditëse {...} dhe palë të paditur Shoqëria "{...}" sh.p.k.

4. Kërkesës nr. {...} prot., datë 30.06.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me objekt "Shpërblim dëmi" me palë paditëse {...} dhe palë të paditur Shoqëria "{...}" shpk.

5. Kërkesës nr. {...} prot., datë 30.06.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me objekt "Shpërblim dëmi ekonomik" me palë paditëse {...} dhe palë të paditur Shoqëria "{...}" shpk.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër

- Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër si vijon:

1. Kërkesës nr. {...} prot., datë 12.07.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me objekt "Detyrim për vazhdim të procedurave për ekzekutim të aktit administrativ" me palë paditëse {...} dhe palë të paditur {...}, {...}.

2. Kërkesës nr. {...} prot., datë 13.07.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me objekt "Shfuqizim vendimi dënimi me gjobë" me palë paditëse Shoqëria {...} sh.p.k. dhe palë të paditur {...} .

3. Kërkesës nr. {...} prot., datë 13.09.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me objekt "Konstatim pavlefshmërie" me palë paditëse {...} sh.p.k. dhe palë të

paditur {...}.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës

- Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Apelit Durrës si vijon:

1. Kërkesës nr. {...} prot., datë 18.05.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me të pandehur: {...} me objekt: Dërgim për gjykim".

2. Kërkesës nr. {...} prot., datë 26.05.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me të pandehur: {...} me objekt: "Kultivim i narkotikëve".

3. Kërkesës nr. {...} prot., datë 30.05.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}etj., akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuar nga nenet 278/1, 89, 300 të K.Penal.

4. Kërkesës nr. {...} prot., datë 08.06.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 108/a/2 të K.Penal.

5. Kërkesës nr. {...} prot., datë 19.04.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë paditëse: {...}, palë të paditur Shoqëria "{...}", me objekt: Pavlefshmëri titulli ekzekutiv.

Gjykata Administrative e Apelit

- Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Apelit si vijon:

1. Kërkesës nr. {...} prot., datë 05.05.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me objekt "Shfuqizim urdhri administrativ" me palë paditëse {...}dhe palë të paditur {...}.

2. Kërkesës nr. {...} prot., datë 28.06.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me objekt "Marrje masë sigurim padie" me palë paditëse {...} dhe palë të paditur {...}.

3. Kërkesës nr. {...} prot., datë 05.05.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me objekt "Detyrim rillogaritje pensioni të parakohshëm" me palë paditëse {...} dhe palë të paditur {...}.

I. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarëve të gjykatave të sipërcituara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.10.2022)

***Pika 2 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

2.1 Për zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...}.

2.2 Për ricaktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit {...}.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:15 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e pesë pikave të para të rendit të ditës Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Naureda Llagami.***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Paola Ndroqi, Përfaqësuese e Universitetit "Epoka".

4. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

5. Edmond Hoxhaj

6. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

2.1 Për zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...}.

2.2 Për ricaktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit {...}.

Ilir Rusi: Sipas rendit të ditës, vazhdojmë me pikën dy, shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën zotit Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Më herët, nga ana e Këshillit, pasi është marrë në konsideratë pëlqimi për të shërbyer në skemën e delegimit nga ana e gjyqtarit z. {...}, është proceduar më tej me vendimin nr. 403, datë 07.10.2020, me anë të së cilës Këshilli ka vendosur:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...}.

2. Komandimin e gjyqtarit z. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit

të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

Si gjyqtar i skemës së delegimit, për shkak të situatës në Gjykatën e Apelit {...} dhe nevojave emergjente të saj në lidhje me funksionalitetin, Këshilli më tej ka proceduar me Vendimin nr. 412, datë 29.09.2021, me anë të së cilit ka ricaktuar z. {...} për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit {...} për të gjithë periudhën e caktimit/komandimit në skemën e delegimit, pra deri më datë 07.10.2022.

Afati i komandimit/caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarit z.{...} është duke përfunduar, ndaj është rasti për të vlerësuar nëse ka vend për zgjatjen e këtij afati.

Sikurse është parashtruar dhe më parë, aktualisht sistemi gjyqësor është në një situate kritike për burime njerëzore, specifikisht për gjyqtarë. Më datë 20.09.2022, në raport me organikat e të gjitha gjykatave (408 gjyqtarë gjithsej), në sistem mungojnë 177 gjyqtarë ose 43,38 %. Në këto mungesa përfshihen 75 vakanca të përhershme dhe 102 vakanca të përkohshme.

Situata më e rëndë paraqitet në gjykata e apeleve, në të cilat, më datë 20.09.2022, mungojnë 55 gjyqtarë (nga 102 gjithsej sipas organikave) ose 53,92%. Në këto mungesa përfshihen 34 vakanca të përhershme dhe 21 vakanca të përkohshme.

Ndër gjykatat e apeleve, situate më dramatike paraqitet në ato të juridiksionit të përgjithshëm, në të cilat, më datë 20.09.2022, mungojnë 45 gjyqtarë (nga 78 gjithsej sipas organikave) ose 57,69% e tyre. Në këto mungesa përfshihen 28 vakanca të përhershme dhe 17 vakanca të përkohshme. Kjo situate në fakt do të kishte qenë akoma më e rëndë, nëse disa nga këto mungesa nuk do të ishin plotësuar nëpërmjet caktimit të 11 gjyqtarëve të skemës së delegimit.

Pra, në realitet, në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm aktualisht ushtrojnë detyrën 25 gjyqtarë që kanë emërimin/caktimin e përhershëm në këto gjykata ose 32,05 %, si dhe 11 gjyqtarë të skemës së delegimit, të cilët që të gjithë vijnë nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Të dhënat konkrete mbi situatën e sistemit gjyqësor në përgjithësi, si dhe çdo niveli gjykate, gjenden bashkëlidhur këtij relacioni, në formë tabelare.

Ndodhur në një situatë të tillë, ndërsa më herët është verifikuar plotësimi nga z.

{...} të kritereve të skemës së delegimit, duke mbajtur në konsideratë se ai ka dhënë pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit, përsëritur dhe me kërkesën e protokolluar në Këshill me aktin nr. {...}, datë 19.09.2022, sikundër dhe faktin se ligji lejon shërbimin në këtë skemë deri në 5 vjet, ndërkohë që z. {...} ka konsumuar vetëm dy vite nga kjo periudhë, përveç se ai ka paraqitur një kërkesë për Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se është vendi për zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...} edhe për një afat tjetër, ndërsa në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor, Këshilli ka obligimin për të plotësuar, për sa është e mundur, vakancat në sistem, aktualisht, në veçanti, ato në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, të cilat paraqesin problematika të rënda në lidhje me funksionalitetin e tyre. Mbi këtë bazë, Komisioni ka paraqitur projektvendimin, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...} deri më datë 01.02.2023, afat që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 07.10.2022.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime nga anëtarët mbi projektvendimin përkatës?

Kalojmë në votim.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim "Për zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...}".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...} deri më datë 01.02.2023, afat që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 07.10.2022.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Vazhdojmë në shqyrtimin e pikës 2 të rendit të ditës, duke ia dhënë fjalën përsëri zotit Toro.

Alban Toro: Ne sapo miratuam zgjatjen e afatit për caktimin në skemën e delegimit të zotit {...}. Kështu që në këtë kontekst, pasi vlerësuam edhe situatën ku funksionaliteti i Gjykatës së Apelit {...} është i cenuar, me anë të këtij relacioni ju propozojmë rimandatimin e këtij gjyqtari pranë kësaj gjykate.

Lidhur me këtë propozim, si shkak për propozimin e këtij projektvendimi është situata në të cilën gjendet aktualisht Gjykata {...}, me një strukturë organizative prej 12 gjyqtarësh, organika në fakt është 7 dhe ndërkohë që efektivisht në detyrë janë 4 (2 janë gjyqtarë nga skema e delegimit). Në formë tabelare jua kam paraqitur në relacion.

Në një situatë të tillë, Gjykata e Apelit {...} vijon të jetë në nevojë për pasjen në vijimësi në detyrë pranë saj edhe të gjyqtarëve të tjerë, çka do të mundësonte gjykimin e çështjeve të regjistruara përpara saj, numër jashtëzakonisht i madh.

Meqenëse z. {...}, në supozimin e miratimit nga Këshilli të projektvendimit për zgjatjen e afatit të caktimit të tij në skemën e delegimit, vazhdon të jetë gjyqtar i skemës së delegimit, nisur nga nevoja imediate e Gjykatës së Apelit {...} si dhe duke pasur parasysh edhe kërkesën e vetë gjyqtarit, protokolluar në Këshill me nr. {...} prot., datë 19.09.2022, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar caktimin e tij në Gjykatën e Apelit {...}, për një periudhë 01.02.2023 të caktimit në këtë skemë, referuar afatit të Vendimit nr. 495 datë 21.07.2022 "Për riorganizimin e Rretheve Gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave", miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Lidhur me këtë fakt vlen të theksohet se sikurse edhe më parë është verifikuar nga Këshilli, se gjyqtari z. {...} ka përvojë profesionale mbi 7 vjet, pra ka përvojën minimale profesionale që kërkon ligji, neni 47, pika 4, të Ligjit nr. 96/2016, për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit, rrethanë kjo që i jep të drejtë Këshillit ta caktojë atë në gjykatën e apelit për periudhën e caktimit në skemën e delegimit, sikurse përcaktohet në shkronjën "a", pika 4, të nenit 45, të këtij ligji.

Kështu që në këtë kontekst, nga ana e Komisionit është përgatitur projektvendimi përkatës, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} ricaktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit {...} për periudhën deri më datë 01.02.2023.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 07.10.2022.

3. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor {...}.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 [...].

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit, zoti Toro!

Ftoj anëtarët e Këshillit nëse kanë diskutime mbi projektvendimin përkatës.

Atëherë, kalojmë në votim.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim "Për ricaktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit {...}".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} ricaktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit {...} për periudhën deri më datë 01.02.2023.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 07.10.2022.

3. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor {...}.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Apelit {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.10.2022)

***Pika 3 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017-2019", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).[1]

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:15 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

[1] Kjo çështje Ishte parashikuar të trajtohej e katërta sipas rendit të ditës.

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e pesë pikave të para të rendit të ditës Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Naureda Llagami.***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Paola Ndroqi, Përfaqësuese e Universitetit "Epoka".

4. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

5. Edmond Hoxhaj.

6. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017-2019", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Ilir Rusi: Pika 3 e rendit të ditës është me dyer të mbyllura. Vazhdojmë me pikën 4 të rendit të ditës, duke ia dhënë fjalën për më tej, relatores znj. Ukperaj.

(Sqarim: Pika 3 e rendit të ditës do të shqyrtohet si pikë e fundit e rendit të ditës.)

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Në vijim po relatoj projektvendimin dhe projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...} për sa i përket periudhës së vlerësimit 2017-2019.

Gjyqtarja është vlerësuar në kuadër të programit të vlerësimit për vitin 2021. Është vlerësuar për një periudhë trevjeçare pune 2017-2019.

Projektraporti i vlerësimit është bazuar mbi të dhënat e burimeve të vlerësimit të cilat janë pasqyruar në mënyrë analitike në raportin analitik të përgatitur nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin.

Aktet i janë njoftuar gjyqtares në adresën e saj elektronike. Brenda afatit të përcaktuar gjyqtarja ka paraqitur kundërshtimet e saj lidhur me projektraportin e vlerësimit si dhe një provë të re e cila ka kërkuar që të vlerësohet në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional, provë e cila nuk është administruar dhe as nuk është paraqitur nga ana e gjyqtares në kuadër të akteve të vlerësimit që tregojnë ngritjen e saj profesionale.

Në pjesën e parë të projektraportit të vlerësimit gjendet e pasqyruar procedura, ndërkohë që gjyqtarja nuk ka kërkuar të dëgjohet në seancë dëgjimore.

Lidhur me vlerësimin sipas katër kritereve të vlerësimit, duke filluar me "Aftësinë profesionale të gjyqtares", treguesi i parë i "Njohurive ligjore".

Nga ana ime si relatore, në përfundim të vlerësimit të këtij treguesi është konstatuar se gjyqtarja ka shfaqur aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës së plotë të fakteve të çështjes, si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit të tyre. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së çështjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim. Në rastet kur ka qenë thelbësore për zgjidhjen e çështjes, gjyqtarja ka vendosur përballë njëra-tjetrës, në plan krahasimor, dispozitat materiale, për të konkluduar mbi kualifikimin ligjor të faktit, kryesisht në çështjet penale.

Për këtë arsye propozohet shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi me 25 pikë.

Për sa i përket "Aftësisë së gjyqtares për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes".

Në projektraportin e vlerësimit gjendet në mënyrë analitike i analizuar respektimi i interpretimit të dispozitave të ligjit material dhe atij procedural, respektimi i parimeve procedurale të së drejtës si dhe përdorimi i jurisprudencës relevante, në përfundim të së

cilit është vlerësuar se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material në funksion të vlerësimit të çështjes me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Ndërkohë dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistonte, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet një kujdes i shtuar i gjyqtares për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor. Parimet e përdorura në interpretimin e ligjit dhe zbatimin e së drejtës, integrohen në arsyetim në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjes konkrete.

Për këtë arsye propozohet shkallë shumë e lartë aftësie e gjyqtares për këtë tregues, pikëzimi me 25 pikë.

Për sa i përket treguesit të "Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit", nga analiza e burimeve të vlerësimit, ka rezultuar që gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes së tij.

Propozohet pikëzimi me 15 pikë, shkallë shumë e lartë aftësie.

Për sa i përket treguesit tjetër që ka të bëjë me "Strukturën e qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit", është evidentuar se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor duke përdorur një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në atë të përmbajtjes.

Për këtë arsye propozohet pikëzimi me 10 pikë, shkalla e aftësisë shumë e lartë.

Për sa i përket treguesit të fundit që ka të bëjë me cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, referuar burimeve të vlerësimit shkalla e aftësisë propozohet si shumë e latë. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit

juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë zbatim. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe gjithëpërfshirës, referuar kërkimeve apo prapësimeve të palëve në çështjet civile, në diskutim si në aspektin procedural ashtu edhe atë thelbësor, duke i dhënë një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Propozohet shkallë shumë e lartë aftësie, 25 pikë.

Për sa i përket kriterit të parë të "Aftësive profesionale të gjyqtares" propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i përket "Aftësive organizative të gjyqtares", treguesi i "Respektimit të afateve ligjore". Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit ka rezultuar që gjyqtarja ka treguar një kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore edhe pse ka pasur një numër shumë të lartë çështjesh me afat ligjor, rreth 348 çështjesh. Nëse në përllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, do të përjashtoheshin çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (1 deri në 5 ditë), si dhe çështjet të cilat janë shortuar në fund të muajit korrik dhe për pasojë, në kohëzgjatjen e tyre ka ndikuar leja vjetore e gjykatës, atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit rezultojnë të jenë 30 çështje në 348 çështje, çka përkon me një përqindje prej 8.6 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor.

Për këtë arsye pikëzimi për këtë tregues propozohet të jetë 15 pikë (përqindje brenda marzhit 0-10% që sipas Metodologjisë i referohet këtij niveli pikëzimi).

Për sa i përket "Plotësimit të standardeve minimale kohore" ka rezultuar se 585 çështje të përfunduara nga 933 çështje në total gjatë periudhës së vlerësimit, kanë qenë çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, nga të cilat 52 prej tyre janë në tejkalim të këtij standardi ose e konvertuar kjo shifër në përqindje, rezulton të jetë në masën 8.8% (afërsisht 9%). Për këtë arsye, duke qenë se përqindja e çështjeve të gjykuara tej standardit orientues minimal kohor rezulton të jetë brenda marzhit nga 0-10%, propozohet pikëzimi me 5 pikë.

Për sa i përket “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, ka rezultuar më e shkurtër se standardi minimal për të gjitha kategoritë e çështjeve. Propozohet pikëzimi në nivelin maksimal me 5 pikë.

Për sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve”, i cili është një tregues për të cilin gjyqtarja ka paraqitur edhe kundërshtimet e saj, do të ndalem në veçanti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) i matur si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (1131 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (933 çështje) brenda vitit kalendarik, është 83 %.

Duke konsideruar faktin që në vitin 2017 gjyqtarja ka ushtruar detyrën për vetëm 1 muaj, treguesit statistikorë për këtë periudhë nuk mund të japin të dhëna të sakta për treguesin e rendimentit, duke qenë se gjyqtarja ka filluar punë në fund të vitit (në fund të muajit nëntor) dhe për pasojë ka ushtruar detyrën për vetëm 1 muaj. Për rrjedhojë, çështjet e caktuara nuk mund të përfundonin për një periudhë kohore të barabartë me 1 muaj, kohë kjo e barabartë ose më e shkurtër se afatet ligjore për disa çështje apo standardi minimal kohor për shumicën e kategorive të çështjeve. Rrjedhimisht, treguesit e vitit 2017 nuk mund të merren në konsideratë në përllogaritjen e rendimentit të përfundimit të çështjeve dhe kjo përllogaritje do të bëhet mbi të dhënat statistikore të viteve të plota të ushtrimit të detyrës, përkatësisht viteve 2018 dhe 2019.

Duke iu referuar numrit të çështjeve të përfunduara, me ato të caktuara për secilin vit, rezulton se:

Për vitin 2018, rendimenti i gjyqtares është 89 %, ndërkohë për vitin 2019, ajo ka një rendiment prej 82 %.

Për të dy vitet së bashku, rendimenti mesatar i përfundimit të çështjeve është 86 % (85.5 %), tregues i cili sipas Metodologjisë, pikëzohet me 4 pikë.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit si gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke renditur si shkak që ka ndikuar në likuidimin e çështjeve, depozitimin e shumë çështjeve gjate muajve gusht dhe dhjetor, kryesisht çështje penale të diktuara nga veprimtaria e organit të akuzës për të mbyllur çështjet për efekt të afateve ligjore si dhe procesit të mbartjes së çështjeve që zhvillohet në fillim të

çdo vit, i cili nuk lejon kryerjen e veprimeve për regjistrimin e çështjeve në sistem. Depozitimi i një numri të madh çështjesh, kryesisht penale, në muajin gusht dhe dhjetor krijon rritje të numrit të çështjeve të mbartura, duke ndikuar në rendimentin e përfundimit të tyre, për shkak të pamundësisë së përfundimit të tyre brenda afateve shumë të shkurtra kohore. Po ashtu si shkaqe që kanë ndikuar në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqtarja ka parashtruar ecurinë procedurale të tyre si p.sh. pezullimin e gjykimeve penale apo kthimin e çështjeve të seancës paraprake për vijimin e hetimeve, etj.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: "Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli. "Sipas pikës 3 shkronja "g", të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje) dhe çështje civile me palë kundërshtare. Ndërkohë rezulton se gjyqtarja, në dy vitet e plota të periudhës së vlerësimit ka përfunduar: (i) për vitin 2018 ka përfunduar 264 çështje me palë kundërshtare, duke tejkaluar standardin me 64 çështje ose 32 %; (ii) ndërkohë për vitin 2019 ka përfunduar 274 çështje, duke tejkaluar me 74 çështje ose 37 % standardin sasior. Ne total për të dy vitet e plota te punës, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja ka përfunduar 538 çështje, duke kaluar standardin me 35 %.

Në cilësinë e relatores së procedurës së vlerësimit, pasi kam vlerësuar dhe kam analizuar jo vetëm nga ana matematikore por edhe logjike, të dhënat statistikore, pavarësisht se rendimenti 86% përkon sipas metodologjisë me pikëzimin prej 4 pikësh, duke marrë parasysh numrin e çështjeve të gjykuara si dhe problematika të referuara në formularët e vlerësimit si nga gjyqtarja ashtu edhe nga kryetari, kam propozuar që gjyqtarja duhet të vlerësohet me një shkallë më të lartë pikëzimi sesa rezulton nga

përqindja matematikore, pra nga 4 pikë në 6 pikë.

Gjyqtarja ka pretenduar në kundërshtimet e saj që pikëzimi i saj për këtë tregues nuk duhet të jetë 6 pikë por duhet të jetë 10 pikë. Në fakt gjyqtarja referon të njëjtat shkaqe të cilat janë analizuar në fakt në projektraportin e vlerësimit. Shkaku kryesor i saj lidhet me rritjen në mënyrë fiktive të një numri të lartë çështjesh që nga ana e prokurorisë shkojnë dhe regjistrohen në gjykata në fillim të muajit dhjetor për mbylljen e vitit të ushtrimit të funksionit. Gjithsesi, nga të dhënat statistikore nuk kemi të dhëna që të themi që në vitin 2018 ka ardhur një numër shumë i lartë çështjesh i cili ka ndikuar në uljen e rendimentit të gjyqtare. Të dhënat statistikore që ne marrim janë vetëm mbi çështjet e përfunduara. Sigurisht që numri i çështjeve të mbartura dhe data e regjistrimit të çështjeve të mbartura në fillimit të muajit janar janë një tregues i pasjes ose jo të ngarkesës. Por gjithsesi, në kushtet kur ngarkesa e gjykatës ka qenë e menaxhueshme, nuk mund të themi që jemi në kushtet që duhet të rritet rendimenti deri në pikëzimin maksimal.

Është e vërtetë që seancat paraprake apo pezullimet e çështjeve mund të rrisin në një farë mënyre rendimentin e gjyqtares, por nga ana e saj, bashkëngjitur kundërshtimeve, nuk janë paraqitur prova për të thënë që kaq çështje janë të pezulluara dhe të cilat automatikisht duhet të hiqen të themi nga numri i çështjeve që kanë shkuar në gjykatë, me qëllim që të rritet rendimenti. Pra kundërshtimet e gjyqtares janë deklarime më shumë, të cilat janë deklarime të përgjithshme, deklarime që dihen në punën e përgjithshme të gjyqtarit dhe që nga ana ime si vlerësuese janë marrë parasysh kur është rritur rendimenti deri me një gradë.

Kështu që nuk kemi pretendime të reja apo pretendime të cilat do të mbështeteshin në prova të reja për të vlerësuar rritjen e rendimentit edhe me një nivel tjetër apo për ta çuar rendimentin në pikëzimin maksimal prej 10 pikësh. Kështu që, pavarësisht kundërshtimeve të gjyqtares për këtë tregues, vlerësoj që rendimenti duhet të pikëzohet me 6 pikë, aq sa kam propozuar edhe në projektraport vlerësimi.

Për sa i përket “Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor”, për të gjitha çështjet, koha e arsyetimit është brenda afatit procedural, kështu që pikëzohet me 15 pikë gjyqtarja.

Për sa i përket “Aftësisë për të kryer procedurat gjyqësore dhe për shmangien e seancave joproduktive”, ka rezultuar që numri mesatar i seancave është 1.9 seanca. Gjyqtarja është produktive në zhvillimin e seancave gjyqësore dhe në shqyrtimin e çështjes, sidomos edhe pas ndryshimit të Kodit të Procedurës Civile. Për këtë arsye propozohet vlerësimi me 15 pikë.

Për sa i përket “Kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e pushtetit gjyqësor”, spikat gjithashtu aftësi e lartë e gjyqtares në drejtim të kryerjes me efiçencë të veprimeve procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse. Propozoj pikëzimin me 20 pikë.

Për sa i përket “Rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes”, “Saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit të dosjes”, përsëri propozohet pikëzimi me 5 dhe 10 pikë, pikëzimi maksimal, pasi nga renditja e akteve rezulton që dosja është lehtësisht e shfrytëzueshme dhe në përbërje të tyre nuk janë konstatuar akte apo mungesë dokumentacioni i cili duhet të jetë administruar në dosje civile apo penale.

Për këtë arsye, për kriterin e dytë, që ka të bëjë me “Aftësitë organizative të gjyqtares” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 96.

Për sa i përket “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, në të gjithë treguesit e këtij kriteri gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht. Nga burimet e vlerësimit ka rezultuar që për periudhën e vlerësimit ndaj gjyqtares nuk ka të administruar asnjë ankesë pranë ILD-së. Nuk ka masa disiplinore që janë zbatuar gjatë periudhës apo edhe masa disiplinore të caktuara më parë. Raporti i ILD-së në lidhje me konfliktin e interesit është pozitiv. Nuk ka pasur të dhëna të tjera që mund të afektonin në vlerësimin e treguesve të tjerë të këtij kriteri. Ndërkohë që, për sa i përket numrit tejet të lartë të kërkesave të palëve për përjashtimin e gjyqtares, rezulton se nuk ka asnjë kërkesë të pranuar për përjashtimin e saj.

Për këtë arsye, për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, propozohet pikëzimi me 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Referuar të gjitha burimeve të vlerësimit kryesisht formularit të mendimit të

kryetarit, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht për “Aftësitë e komunikimit të qartë dhe transparent me kolegët dhe me administratën gjyqësore” për “Respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, si dhe për “Pjesëmarrjen në programet e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, ku ka rezultuar se ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale gjithsej 11 aktivitete të zhvilluara për 17 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15-120 ditë për të gjithë periudhën 3-vjeçare ose 10 - 83 ditë, në proporcion me kohën e ushtrimit të detyrës gjatë periudhës së vlerësimit (25 muaj). Pikëzohet me 20 pikë.

Për sa i përket “Disponueshmërisë së gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, nuk ka pasur të dhëna. Pikëzimi është 3 pikë.

Për sa i përket “Pjesëmarrjes së gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, fillimisht, në momentin kur është hartuar projektraporti i vlerësimit dhe bazuar në aktet e vlerësimit që janë paraqitur nga kryetari i gjykatës nuk ka pasur të dhëna që duhet të analizohen në kuadër të këtij treguesi, prandaj propozohet pikëzimi me 3 pikë, ndërkohë në kundërshtimet e saj gjyqtarja kërkon që pikëzimi i saj për këtë tregues të bëhet me 5 pikë, duke paraqitur një vërtetim, një provë të re që është vërtetimi nr. 221 prot., datë 08.06.2022, i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër (është nënshkruar në fakt nga kancelari i gjykatës), ku evidentohet se gjyqtarja ka marrë pjesë në datën 23 nëntor 2018 në takimin e organizuar në qytetin e Peshkopisë në një takim të organizuar nga shërbimi ligjor falas në bashkëpunim me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër për prezantimin e projektit “Për ofrimin e ndihmës juridike për grupe dhe individët vulnerabël në qarkun e Tiranës”. Qëllimi i takimit ka qenë që të informojë partnerët tanë, gjykatën, strukturat shtetërore dhe ato komunikare për mënyrën e funksionimit të kësaj zyre; të prezantojë disa tema praktike të ofrimit të ndihmës juridike falas për partnerët dhe bashkëpunëtorët që janë në shërbim të individëve vulnerabël.

Referuar këtij lloj aktiviteti, në cilësinë e vlerësueses konstatoj dhe vlerësoj që ky nuk përbën veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë. Ka një takim që

ka qenë informues, përfshirë edhe gjyqtarët e gjykatës. Nuk është se gjyqtarja të ketë dhënë kontribut të veçantë në kuadër të atyre treguesve dhe atyre rrethanave të cilat parashikon metodologjia për veprimtari ndërinstitucionale.

Ndërkohë, në këtë vërtetim është pasqyruar gjithashtu fakti që gjyqtarja ka dhënë ndihmën e saj duke trajnuar, praktikuar dhe vëzhguar studentët praktikantë që kanë kryer praktika mësimore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Konkretisht:

Ka ndjekur praktikanten znj. {...}, studente në Universitetin Ndërkombëtar Strugë, Fakulteti i Shkencave Juridike, në vitin e tretë, që ka ushtruar praktikën mësimore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër (5 janar – 6 shkurt 2018).

Dhe në vijim, për të mos i lexuar sepse ju provat i keni (dhe për efektivitet të kohës), është pasqyruar që gjyqtarja është angazhuar për ndjekjen e praktikës mësimore për studentët në vitin e tretë të disa universiteteve (Universiteti Ndërkombëtar Strugë, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, dega Drejtësi, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, Kolegji Universitar i Biznesit), janë rreth 8 praktika mësimore të ndjekura prej saj në periudhën 2017-2019.

Referuar metodologjisë së pikëzimit, duke qenë se kontributi i gjyqtarëve në mësimdhënie apo ndjekje të praktikave të studentëve gjatë fakultetit të drejtësisë apo gjatë kohës kur ata kryejnë arsimin e lartë, Dega Juridik, edhe më tej, është vlerësuar në kuadër të metodologjisë dhe është përcaktuar si një lloj aktiviteti i cili konsiderohet si veprimtari ndërinstitucionale e gjyqtarit. Konkretisht metodologjia përcakton për sa i përket pjesëmarrjes së gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata, përcakton se këto veprimtari përfshijnë veprimtari jashtë funksionit me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, pjesëmarrje në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programit të formimit vazhdues; angazhimin si ekspertë në punën e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efiçencës; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër

e ngjashme në fushën juridike, etj.

Për këtë arsye, referuar provave të tjera të depozituara nga ana e gjyqtares, vlerësoj që për këtë tregues, pikëzimi i saj nga 3 pikë duhet të bëhet 5 pikë.

Referuar "Publikimeve ligjore akademike", nuk ka publikime për këtë periudhë. Kështu që propozimi është për pikëzimin me 0 pikë.

Përfundimisht për kriterin e "Aftësive personale dhe angazhimit profesional", pikëzimi nga 91 pikë, propozohet pas provave të reja 93 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Përfundimisht gjyqtarja propozohet të vlerësohet për kriterin e "Aftësive profesionale"- "Shkëlqyeshëm", 100 pikë. Për kriterin e "Aftësive organizative"- "Shkëlqyeshëm", 96 pikë. Për kriterin e "Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale" – "Shkëlqyeshëm", 100 pikë. Për kriterin e "Aftësive personale dhe angazhimit profesional" – "Shkëlqyeshëm", 93 pikë. Përfundimisht "Shkëlqyeshëm" me pikët 389.

Në përfundim të projektraportit të vlerësimit janë përgatitur edhe disa propozime dhe rekomandime që gjyqtarja duhet t'i ketë parasysh në vijim të punës së saj duke rekomanduar angazhimin e saj në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të saj edhe në këto fusha.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime nga anëtarët?

Po zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Në lidhje me raportin, doja të ndalesha tek paragrafi për "Rendimentin në përfundimin e çështjeve gjyqësore", pasi edhe Metodologjia e Pikëzimit bazohet në pjesën që përfundimet që duhet të arrihen në këtë metodologji kanë të bëjnë me faktin për të gjitha ato që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, pra shmang përgjegjësinë e gjyqtarit për rrethana të cilat mund të ndikojnë në zvarritjen apo në mos përmbylljen e

dosjes brenda afatit kohor të caktuar. Të tjera pastaj janë edhe kompleksiteti i çështjes, volumi, rritjen e papritur të volumit të çështjeve etj., dhe në këtë metodologji thuhet: "të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës, deri në pikëzimin maksimal". Çfarë do të thotë, ne në fakt të gjithë jemi koshient dhe e dimë se si funksionon problematika me prokurorinë. Pra ne gjyqtarët e dimë që muaji korrik është muaj sulmi i prokurorisë të cilët sjellin dosje për efekt të statistikave, duke llogaritur që është muaji gusht e mos t'i quhet atyre (ndërhyrje në audio)... E dyta, kemi pjesën e muajit dhjetor, edhe tek kjo situatë, duke qenë se bëhet mbartja e dosjeve në janar, fiktivisht ngarkohen gjyqtarët me numër dosjesh dhe prokuroria në atë periudhë sjellë dosje të reja, të cilat siç thashë janë për efekt të afateve të paraburgimit apo të afateve të mbartjes apo edhe afate që ato mund të kenë... dhe për të pastruar dosjet nga mbartja e tyre, kalojnë tek gjykata dhe kjo gjë rëndon fiktivisht gjykatën, pra po them fiktivisht gjyqtarin dhe mund të ndikojë në këtë rendimentin e saj, pasi ty të vijnë 10 dosje, po themi, dhe nga ato 10 dosje, duke lëvizur kjo përqindja ti nuk kap ato përqindjet si gjyqtar.

E dyta, duke marrë shkas edhe nga ky pretendimi që kishte edhe vetë gjyqtarja, kemi të bëjmë me parashikimet e nenit 352 dhe në lidhje me 140 që kanë të bëjnë me personin që nuk gjendet. Ka një kategori shumë të madhe të personave që nuk janë dhe që gjykohen në mungesë dhe siç e dimë, ligji ka detyrimin që duhet për një vit kjo pjesë të përfshihet, pra të mbahet dosja për një vit derisa i pezullohet, por kjo përfshihet në pjesën... e pezullon një vit dhe pastaj vazhdon gjykimi. Në këtë kuadër, përsëri rëndohet gjyqtari, por jo për fajin e tij. Pra të gjitha këto që thashë kanë të bëjnë jo për fajin e tij. Si dhe ka edhe probleme të tjera pastaj procedurale të cilat mendoj që duhet të kihen parasysh dhe të përjashtojnë... pra të vijmë tek pjesa që gjyqtari të japi me të vërtetë atë që meriton, për atë që ka punuar dhe ndoshta të shkojmë tek pjesa që siç e citon edhe metodologjia, meqenëse nuk provohet e kundërta, të marrë një pikëzim më të lartë deri në pikëzimin maksimal.

Kjo është ajo që doja të thosha. Pas kësaj, nëse nuk ka gjë tjetër, do propozoja që nga 6 pikë të marrë pikëzimin maksimal me 10 pikë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime të tjera nga anëtarët mbi çështjen në fjalë?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Atëherë, të gjithë ato sa u parashtruan nga zoti Hallunaj, janë të drejta që ne si gjyqtarë i ndeshim në punën tonë të përditshme, por procesi i vlerësimit është një proces që vepron mbi baza dokumentare. Pretendimet e gjyqtares, duke qenë se kanë qenë pretendime të përgjithshme dhe pretendime që ne i dimë të gjithë, që në fund të vitit sigurisht që vjen një sasi e lartë çështjesh. Nuk e di se sa shkon në Gjykatën e Dibrës. Edhe në muajin korrik, po, vjen një numër i lartë çështjesh. Po sa shkojnë në Gjykatën e Dibrës? Sa kanë shkuar në 2017, 2018? Në 2017 gjyqtarja nuk ka gjykuar dhe nuk ka pasur rritje të numrit të çështjeve të 2018 për shkak të 2017 sepse ajo ka ikur me leje barrë lindjeje. Kështu që gjyqtarja në 2018, sa ka shkuar në punë ka marrë vetëm çështje të reja, nuk ka pas marrë çështje të mbartura.

Nëse ne do të dinim sa është numri i këtyre çështjeve që gjyqtarja ka pasur të pezulluara, sa është numri i çështjeve që gjyqtarja i ka pasur të kthyera në seanca paraprake dhe i ka pasur akoma në shqyrtim, që ia kanë rritur numrin e çështjeve. Ka edhe një diçka tjetër, rendimenti nuk llogaritet mbi bazën e çështjeve që gjyqtarja ka në ngarkesë, por llogaritet mbi bazën e çështjeve të reja që shkojnë në atë vit me çështjet e përfunduara në atë vit. Mund të ndodhë që në atë vit të shkojnë më pak çështje të reja dhe gjyqtarja të heqë më shumë sepse heq backlog. Kjo është logjika e rendimentit.

Duke qenë se kundërshtimet e gjyqtares kanë qenë të përgjithshme, pra nuk kanë qenë të bazuara në të dhëna statistikore, unë si vlerësuese, duke marrë parasysh edhe praktikën e vlerësimeve të tjera, nuk mund t'ia rritja më tepër sesa një shkallë në pikëzimin e gjyqtares. Kurrsesi nuk i mohohet puna gjyqtares, se ajo është një gjyqtare shumë produktive, shumë efektive, që rrallëherë na ndodh të shohim që të ketë një numër mesatar për shembull prej 2 seancash. Kjo ka qenë arsyeja që pikëzimi është rritur me një shkallë. Nëse Këshilli vlerëson që bazuar vetëm në kundërshtimet e gjyqtares, deklarimet e përgjithshme, ne mund të shkojmë deri në pikëzim maksimal, sigurisht që ky është një vlerësim i Këshillit dhe sigurisht do ta respektoj. Faleminderit!

(Anëtarët diskutojnë pa mikrofona.)

Ilir Rusi: Zoti Kurushi, keni propozim?

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Ndjesë për ndërhyrjen pa radhë.

Përtej propozimit që ka bërë kolegu Hallunaj edhe unë do bëja një propozim pas diskutimit që u bë në mes kolegëve. Mendoj që ta rrisim një gradë. Domethënë nga 6 ta çojmë në 8. Është alternative. Përtej këtij propozimi që është bërë, ta çojmë në 8.

Ilir Rusi: Ka propozime të tjera?

Atëherë, të nderuar anëtarë, do kalojmë në votimin e propozimeve... (ndërpritet mendimi)

Atëherë, të nderuar anëtarë, kalojmë në votimin e dy propozimeve, propozimit të zotit Hallunaj që është nga 6 në 10 dhe në propozimin e zotit Kurushi nga 6 në 8. Ose propozimi i tretë i Komisionit që është 6 pikë.

Do të hedh propozimin e zotit Hallunaj fillimisht.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Pro.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Kundër.

Pra propozimi i zotit Hallunaj për të rritur marzhin e vlerësimit nga 6 në 10, me votat e shumicës bie.

Vazhdojmë me miratimin e propozimit të dytë, të zotit Kurushi, nga 6 në 8.

Irena Plaku: Për sa i përket propozimit të Klodit, jam dakord me rritjen e një niveli të rendimentit, duke qenë se në disa raste kur kemi pasur arsye (megjithëse në këtë rast në fakt nuk e ka kaluar 50%) por kemi çuar edhe me dy nivele, megjithëse nuk ka sjellë prova, duke pasur parasysh rrethanat, mendoj që të kalojmë në rritje me dy nivele, d.m.th. nga 4 që ka qenë, duke shkuar në 8 (propozimi i zotit Kurushi). Jam pro propozimit të z. Kurushi.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë, me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit u vendos që për këtë rubrikë të vlerësohet nga 6 në 8 pikë.

Vazhdojmë tani në miratimin përfundimtar...

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Edhe propozimin që bëra unë si relatore që të rriten dy pikët tek treguesi i veprimtarive ndërinstitucionale sepse ka paraqitur prova.

Ilir Rusi: Ju lutem zonja Ukperaj, perifrazoje edhe një herë propozimin tuaj që ta kalojmë në votim.

Brikena Ukperaj: Atëherë, për sa i përket treguesit të pjesëmarrjes së gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë në marrëdhëniet me publikun në gjykata, referuar provave të reja të paraqitura nga ana e gjyqtares, vlerësoj që pikëzimi për këtë tregues nga 3 pikë duhet të bëhet 5 pikë sepse ka të dhëna që tregojnë kontributin e gjyqtares.

Ilir Rusi: Keni diskutim mbi këtë propozim përpara se ta kalojmë në votim?

Atëherë, kalojmë në votimin e propozimit të zonjës Ukperaj për këtë rubrikë.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë, ftoj Këshillin të kalojmë në miratimin përfundimtar të projektvendimit përkatës, duke marrë në konsideratë dy ndryshimet që u bënë me shumicë votash të anëtarëve të Këshillit: për rubrikën përkatëse të propozuar nga zoti Kurushi nga 6 në 8 pikë dhe për rubrikën përkatëse të propozuar nga zonja Ukperaj nga 3 në 5. Raporti përfundimtar do miratohet së bashku me këto ndryshimet përkatëse.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Përpara se të lexoj vendimin përkatës të marrim në konsideratë edhe reflektimet e ndryshimeve që na ndodhën për shkak të vendimmarrjeve që u morën nga Këshilli

përgjatë kësaj mbledhjeje në lidhje me rastin e gjyqtares znj. {...}.

Vendim "Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...} për periudhën 2017-2019". Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019", duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";

B. Aftësitë organizative – "Shkëlqyeshëm";

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm";

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shkëlqyeshëm".

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – "Shkëlqyeshëm".

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.10.2022)

***Pika 4 e rendit të ditës me objekt**:* Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave 27.07.2022, 03.08.2022, 15.08.2022, 08.09.2022, 13.09.2022.[2]

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:15 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

[2] Kjo çështje Ishte parashikuar të trajtohej e pesta sipas rendit të ditës.

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e pesë pikave të para të rendit të ditës Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Naureda Llagami.***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Paola Ndroqi, Përfaqësuese e Universitetit "Epoka".

4. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

5. Edmond Hoxhaj

6. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

4. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave 27.07.2022, 03.08.2022, 15.08.2022, 08.09.2022, 13.09.2022.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me shqyrtimin e pikës 5, miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 27.07.2022, 03.08.2022, 15.08.2022, 08.09.2022, 13.09.2022.

Ftoj anëtarët e Këshillit në miratimin e tyre nëse nuk kanë diskutime mbi përmbajtjen e këtyre procesverbaleve.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim "Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 27.07.2022, 03.08.2022, 15.08.2022, 08.09.2022 dhe 13.09.2022.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.10.2022)

***Pika 5 shtesë e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, në detyrën e Zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}", i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:15 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

11. Ilir Rusi	***(zëvendëskryetar)***
12. Klodian Kurushi	***(anëtar)***
13. Fatmira Luli	***(anëtare)***
14. Irena Plaku	***(anëtare)***
15. Dritan Hallunaj	***(anëtar)***
16. Ridvan Hado	***(anëtar)***
17. Alban Toro	***(anëtar)***
18. Marçela Shehu	***(anëtar)***

19. Brikena Ukperaj ***(anëtare)***

20. Yllka Rupa ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e pesë pikave të para të rendit të ditës Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Naureda Llagami.***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Paola Ndroqi, Përfaqësuese e Universitetit "Epoka".

4. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

5. Edmond Hoxhaj

6. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

5 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, në detyrën e Zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}", i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

Ilir Rusi: Për më tej, sikur edhe u bëtë me dije, me propozim të Komisionit të Disiplinës, u kërkua që të vazhdohet nga ana e Këshillit për t'u përfshirë në rendin e ditës shqyrtimi i procedurave të mëtejshme në lidhje me rastin e zotit {...}, ardhur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Do doja të ftoja edhe një herë anëtarët e Këshillit nëse janë dakord që këtë çështje ta shqyrtojmë në rendin e ditës së sotshme.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Gjithsesi ne dakordësuam edhe kur ishim me dyer të mbyllura, për efekt të transparencës dhe publikimit, atëherë rimorëm edhe një herë vullnetin e anëtarëve të Këshillit për të përfshirë këtë çështje në rendin e ditës.

Për më tej ia jap fjalën relatorit përkatës, z. Hado.

Ridvan Hado: 1. Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. {...} prot., datë 22.09.2022 është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, në detyrën e Zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}. Kërkesë me të cilën Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj magjistratit z. {...} të masës disiplinore "Vërejtje publike", të parashikuar nga neni 107 i Ligjit nr. 96/2016 për Statusin.

Me raportin e zhvillimit të hetimit disiplinor, faktet dhe rrethanat e pretenduara si dhe shkeljet e pretenduara i keni të pasqyruara, jeni njohur.

Në referim të nenit 31 të Rregullores "Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor", në cilësinë e Relatorit të çështjes, kam bërë verifikimet nëse ekzistojnë rastet e parashikuara nga neni 139 të Ligjit "Për Statusin" që pengojnë Këshillin që të vazhdojë përcaktimin e seancës dëgjimore dhe të shkojë në vendimmarrje për mbylljen e procedimit disiplinor, pa zhvilluar këtë seancë.

Kërkesa e parë e nenit 117 nëse shkelja disiplinore është e parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi nuk rezulton të jetë e parashkruar. Është brenda afatit 5-vjeçar të kërkuar nga ligji. Shkelja e pretenduar është e datës 13.07.2021, ndërkohë, hetimi ka filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datë 24.12.2021. Nuk ka qenë çështja objekt i ndonjë procedimi tjetër disiplinor që të jetë zgjidhur me vendim përfundimtar. Nga

verifikimet e kryera nuk rezulton pra që shkeljet e pretenduara të kenë qenë objekt i ndonjë procedimi tjetër disiplinor që të ketë përfunduar me vendim të formës së prerë. Gjithashtu nuk rezulton që të ketë arsye të tjera për ta mbyllur procedimin në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronja "ç" dhe "d" të Ligjit "Për Statusin". Janë verifikuar ato sipas kërkesave të nenit 64, pikës 1, germave "b" dhe "ç", si dhe 67 të ligjit për Statusin.

Nga të dhënat në dosjen hetimore nuk rezultoi e provuar ekzistenca e ndonjë prej këtyre shkaqeve.

Po ashtu nuk rezulton që raporti hetimor i depozituar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë të jetë i paarsyetuar sipas kërkesave të parashikuara në paragrafin e tretë të nenit 133, të Ligjit për Statusin. Raporti i depozituar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë është i arsyetuar, plotëson të gjithë elementët formalë të kërkuar nga dispozita e mësipërme.

Gjithashtu nga ana e Komisionit, në mbledhjen e datës së sotshme, 04.10.2022, mbi relacionin e relatorit dhe aktet e ndodhura në dosje, u vendos kalimi i çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit, për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kalimin e çështjes në seancë dëgjimore dhe caktimin e datës dhe orës për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, ose mbylljen e procedimit disiplinor pa caktuar seancë dëgjimore.

Nga sa më sipër, në cilësinë e relatorit, meqenëse nuk ndodhemi në asnjë nga rastet e parashikuara të sipërcituara për mbylljen e procedimit disiplinor, i propozoj mbledhjes plenare kalimin e çështjes për shqyrtim të mëtejshëm në seancë dëgjimore që duhet vendosur brenda 1 muaji nga data e depozitimit të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që është data 26.09.2022. Të kemi parasysh që të marrim në konsideratë afatin 15-ditor për njoftimin e palëve. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Ftoj anëtarët e Këshillit për diskutime përkatëse në lidhje me rastin.

Po zoti Hado!

Ridvan Hado: Atëherë, si relator i çështjes propozoj si datë, datën 25 tetor, ora 11:00.

Ju faleminderit!

Ilir Rusi: Ju faleminderit zoti Hado!

Përderisa s'ka diskutime, ftoj Këshillin për të miratuar vendimin përkatës, duke marrë në konsideratë datën e propozuar nga relatori zoti Hado në lidhje me mbajtjen e seancës dëgjimore dhe orën përkatëse.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord me propozimin.

Ilir Rusi: Dakord. *(Vota e zotit Rusi nuk është bërë e mundur të dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)*

Vendim "Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, në detyrën e Zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e datës 25 tetor 2022, ora 11:00, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit, z.{...}, në detyrën e Zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe z.

{...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

Faleminderit!

Çështja e vetme që është, është çështje me dyer të mbyllura. Ju faleminderit!

* * *

(Pika 5 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor